



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 316, datë 19.12.2019

PËR

**MIRATIMIN E TABELAVE STANDARDE ME TË DHËNA STATISTIKORE TË
NEVOJSHME PËR EFEKT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË
GJYQTARËVE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, si dhe në nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, me propozimin e Komisionit të Etikës dhe Vlerësimit Profesional,

VENDOSI:

1. Miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas listimit dhe formatit bashkëlidhur vendimit, pjesë përbërëse e tij (Lidhja 1 dhe Lidhja 2).
2. Tabelat hartohen në format shkresor dhe elektronik që kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR